



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Rexha” Sh.P.K. të datës 15.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugës që lidh rrugën 1 Tetori me rrugën Isa Kastrati” me nr. të prokurimit 616-23-12047-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Rexha” Sh.P.K. e datës 15.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugës që lidh rrugën 1 Tetori me rrugën Isa Kastrati” me nr. të prokurimit 616-23-12047-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi ndërsa njoftimi mbi vendimin i datës 08.04.2024 mbetet në fuqi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Rexha” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Rexha” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 15.04.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugës që lidh rrugën 1 Tetori me rrugën Isa Kastrati” me nr. të prokurimit 616-23-12047-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës. Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Pretendimi nr. 1 - "Kontrata e punes per kohe te caktuar e lidhur ne mes Termomontimit dhe inxhinierit ne fjale nga vete datat shihet se eshte lidhur para njoftimit per kontrate dhe ka qene e vlefshme per te gjitha projektet ne ti cilat merr pjese Termomontimi. Sa i perket kerkeses se lartecekur kjo e fundit nuk do ta permbushte kerkesen e AK, andaj inxhinieri ne fjale ka lidhur kontrate me kompanine tone per kete projekt".

Pretendimi nr. 2 - "Fillimisht, ne asnje pike te dosjes se tenderit nuk eshte kerkuar autorizim per nenshkrim te kontratave per persona qe nuk jane te regjistruar ne ARBK. AK nese ka pasur paqartesi ne lidhje me kete pike mund te kerkoj sqarime shtese ne perputhje me nenin 72 te LPP".

Pretendimi nr. 3 - "Kosiderojme te pakuptimte dhe tendencioz pretendimin e AK per te perdorur si arsyetim eliminimi kete pike pasiqe dokumenti me nr.11 i emeruar si Marreveshje per furnizim me beton, brenda tij ka marreveshjen, dokumentet e kompanise dhe licensat e kerkuara".

Pretendimi nr. 4 - "Lista e maknierise te kompanise Haxha com SHPK eshte paraqitur se bashku me te gjitha dokumentet mbeshtetese. Gjate skenimit te dokumentacionit voluminoz Marreveshja e cila ishte e bashkangjitur eshte skenuar se bashku me nje dokument tjetër dhe nuk eshte paraqitur si i tille. Ju njoftojme qe e posedojme marreveshjen per makineri dhe vlen te theksohet se marreveshjet per furnizim me asfalt dhe zhavor jane po me te njejten kompani, pra HAXHA COM SHPK, dhe si i tille finisheri eshte paisje qe perdoret nga kompania per shtrim te asfaltit, automatikisht keto paisje hyjne edhe ne marreveshjet per furnizim".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

1. Termomontimi & Rexha

Ky Operator Ekonomik eliminohet për këto arsye:

- a. Nuk e ka plotësuar kushtin administrativ, konkretisht pjesën I të Formularit të Tenderit pika 3 nën kriteret 1 dhe 2, andaj ky eliminim është konform udhëzuesit për Prokurim Publik nr. 001/2023 pikës 10, ku shkruan si në vijim:

| Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm | Kusht administrativ |
|--|---|---------------------|
|--|---|---------------------|

- a. Ky Oe te kriteri kriteri 9.1&9.2 kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika B, për inxhin e Ndërtimtarise – Drejtimi Konstruktiv apo fushës së ndërtimit të rrugëve ka prezantuar dy kontrata të punës, njera kontrate për këtë aktivitet ndërsa tjetra me kohë të caktuar prej dt. 18.05.2023 deri me dt. 18.05.2024.
- b. Kontratat e punëtorëve të "Termomontimi" të paraqitur në liste janë të nënshkruar nga Blond Mecinaj i cili në certifikate të regjistrimit të biznesit nuk figuron si pronar apo person i autorizuar. Në dosje të këtij OE nuk është gjetur "Autorizim" me shkrim për Blond Mecinaj.
- c. Ky grup i OE nuk e ka prezantuar dëshmi për bazën e betonit apo "Marrëveshje furnizimi" me një bazë të prodhimit të betonit, sipas kriterit 9.1&9.2 kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pikës 4
- d. Këtij OE i mungon "Marrëveshja për huazim" me "Haxha" com për finisher sipas kërkesës nga Aneksi 7. Lista e pajisjeve profesionale

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 1 – ky pretendim ankimor i referohet kërkesës në dosjen e tenderit e cila është formuluar si në vijim:

- Një (1) Inxhinier i Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktivë apo fushës së ndërtimit të rrugëve
- Kontratën e punës të **përhershme** ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët.

Në rastin konkret nuk është fare kontestues fakti që parashtruesi për këtë kërkesë të dosjes së tenderit nuk ka prezantuar kontratën e punës së përhershme për inxhinierin e ndërtimtarisë. Në pretendimin ankimor parashtruesi nuk e konteston që nuk e ka dorëzuar së bashku me ofertë kontratën e përhershme dhe as nuk e konteston faktin kontrata e dorëzuar është kontratë e përkohshme e cila është e vlefshme vetëm edhe një muaj përkatësisht vetëm deri me datë 18.05.2024. Sidoqoftë nga administrimi i dokumenteve me të cilat ka ofertuar parashtruesi është gjetur se i njëjti ka dorëzuar një kontratë të përkohshme të punës të vlefshme nga data 18.05.2023 deri me datë 18.05.2024 dhe nuk ka dorëzuar kontratën e përhershme të punës sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 2 – parashtruesi pretendon që nuk është kërkuar që dokumentet me të cilat ai ka ofertuar duhet të jenë të nënshkruara nga drejtori i tij menaxhues apo personi tjetër i autorizuar. Me fjalë të tjera as në këtë rast parashtruesi nuk e konteston faktin se të gjitha kontratat e OE “Termomontimi” janë të nënshkruara nga një person i cili as nuk është drejtor menaxhues dhe as nuk është person i autorizuar për veprime të tilla. Sa i përket pretendimit ankimor të parashtruesit, duhet theksohet se nënshkrimi i dokumenteve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë tregtare respektivisht të parashtruesit është rregulluar me ligjin 06/L-016 për shoqëritë tregtare (shih nenin 109 par. 1 nënpar. 1.2 lidhur me nenin 107 dhe 111 et. al.). Në këtë drejtim pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 3 – pretendimi ankimor i referohet kërkesës në dosjen e tenderit të formuluar si në vijim:

| | |
|---|--|
| 4. Bazën e prodhimit të materialit të betonit | 4. Duhet të dëshmohet pronësia e bazës së prodhimit të betonit apo duhet kontratë furnizimi me një bazë të prodhimit të betonit për këtë kontratë, leja e bazës së betonit duhet të jetë me validitet të paku deri në përfundim të kontratës. |
|---|--|

Nga administrimi i ofertës së dorëzuar nga parashtruesi është gjetur se i njëjti ka dorëzuar një marrëveshje për furnizim me beton me operatorin ekonomik R.U.B. Sh.P.K. të cilës i ka bashkangjitur edhe lejën përkatëse me nr. 767/KPMM/2019. Prandaj ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 4 – duhet cekur se për parashtruesin nuk është fare kontestues fakti që parashtruesi nuk e ka dorëzuar marrëveshjen për huazim të finisherit sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Megjithatë parashtruesi pretendon se ky dokument nuk është dorëzuar për shkak se ka pasur shumë dokumente të cilat është dashur që të bashkangjiten në ofertë dhe për pasojë nuk është bashkangjitur edhe dokumenti në fjalë.

Sidoqoftë, nga administrimi i ofertës së parashtruesit është gjetur se parashtruesi nuk e ka bashkangjitur në ofertë edhe dokumentin për të cilin po bëhet fjalë sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të parashtruesit, duhet theksuar faktin se parashtruesi nuk e ka përmbushur kushtin administrativ konkretisht pjesën I të formularit të dosjes së tenderit pika 3 nënkriteret 1 dhe 2 andaj eliminimi i ofertës së parashtruesit si të papërgjegjshme është bërë në përputhje me pikën 10 të UPP ku përcaktohet si në vijim:

| | | |
|--|---|---------------------|
| Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm | Kusht administrativ |
|--|---|---------------------|

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij me nr. 1, 2 dhe 4 ndërsa ka paraqitur argumente vetëm sa i përket pretendimit ankimor me nr. 3. Megjithatë kthimi në rivlerësim i aktivitetit të prokurimit vetëm për shkak të pretendimit nr. 3 nuk do të ndryshonte epilogun përfundimtar të aktivitetit të prokurimit prandaj nuk mund të ndryshoj as epilogun e këtij vendimi. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është miratuar si pjesërisht e bazuar mirëpo njoftimi mbi vendimin i datës 08.04.2024 është vërtetuar ndërsa Autoriteti Kontraktues është autorizuar që të vazhdoj tutje me këtë aktivitet të prokurimit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.04.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës, i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.